



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 98/3 Prot.

Tiranë, më 13.01 .2026

**VENDIM**

Nr. 5 Datë 13-01 2026

**“PËR  
MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË  
PËRBASHKËT “MASTER I SHKENCAVE” NË “SHKENCA SPORTIVE” ME  
DIPLOMË TË DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË  
TIRANËS, FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES DHE UNIVERSITETIT  
TË URBINOS “CARLO BO”, ITALI”**

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, në nenin 7, 43 të Statutit të UST-së, në Rregulloren e UST-së, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 10 datë 13.01.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 13.01.2026,

**V E N D O S I :**

01. Miratimin e marrëveshjes për hapjen e programit të përbashkët "Master i Shkencave" në "Shkenca Sportive", me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe Universitetit të Urbinos "Carlo Bo" (bashkëlidhur vendimit).
02. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

Artur ÇOBANI

**NË MUNGESË DHE ME POROSI**

Prof. Asc. Dr. Marsela SHEHU

